



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-04

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 shkurt 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe ex parte

URDHËR

Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenin 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 86(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe ex parte (“Aktakuza”) së bashku me materialet provuese në mbështetje të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

II. PARASHTRIME

2. Në Aktakuzë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) akuzon Pjetër Shalën (“z. Shala”) për krime lufte sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, përkatësisht, ndalim arbitrar (Pika 1), trajtim mizor (Pika 2), torturë (Pika 3) dhe vrasje e paligjshme (Pika 4).³

3. Sipas ZPS-së, z. Shala mban përgjegjësi penale individuale sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, për:

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte, me Shtojcat 1 (“Aktakuza”), 2 (“Përmbledhje”) dhe 3 (“Procesverbal plotësues”, Policia Gjyqësore Federale, Belgjikë), rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.

³ Aktakuza, para. 22.

a) kryerje: kryerje fizike (për Pikat 1-3)⁴ dhe pjesëmarrje në një ndërmarrje kriminale të përbashkët (në formën bazë për Pikat 1-4 dhe ndryshe për Pikën 4 në formën e zgjeruar);⁵ dhe/ose

b) ndihmë dhe inkurajim (Pikat 1-4).⁶

4. ZPS-ja ndër të tjera kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake ta konfirmojë Aktakuzën dhe të lëshojë një fletarrestim dhe një urdhër për transferim për z. Shala.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, në aktakuzë jepen emri dhe të dhënat personale të të dyshuarit, një përshkrim i shkurtër i fakteve të çështjes dhe i krimeve për të cilat akuzohet i dyshuari, në veçanti forma e përgjegjësisë penale të pretenduar sipas nenit 16 të Ligjit në lidhje me krimet e paraqitura në aktakuzë.

6. Në bazë të nenit 39(1) të Ligjit dhe rregullës 86(4) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën. Gjatë këtij shqyrtimi, në bazë të rregullës 86(4)(a) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund t'i kërkojë ose të lejojë Prokurorin e Specializuar të dorëzojë material shtesë në mbështetje të cilësdo ose të gjitha akuzave. Më tej, në bazë të rregullës 86(4)(b) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu mund të kërkojë prej Prokurorit të Specializuar që të rishikojë aktakuzën me synimin që të japë më shumë hollësi për cilëndo apo për të gjitha akuzat dhe

⁴ Aktakuza, para 12-13.

⁵ Aktakuza, para 7-9.

⁶ Aktakuza, para 12, 14.

⁷ Aktakuza, para 1, 4, 21.

veprimet konkrete të të dyshuarit, ose të mundësojë më shumë saktësi ligjore, ose më shumë qartësi në paraqitjen e akuzave.

7. Në pajtim me nenin 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë të informohet pa vonesë dhe me hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij. Sipas nenit 21(4)(c) të Ligjit, i akuzuari gëzon të drejtën e kohës dhe mjeteve e mundësive të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet. Në bazë të nenit 21(4)(d) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme.

IV. DISKUTIM

8. Aktakuza pasqyron synimin e prokurorit për të nxjerrë të akuzuarin në gjyq në lidhje me veprimet që përshkruhen në aktakuzë. Në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, në aktakuzë jepen: (i) emri dhe të dhënat personale të të dyshuarit; (ii) një përshkrim i shkurtër i fakteve të çështjes, d.m.th., i fakteve mbi të cilat bazohen akuzat; dhe (iii) një përshkrim i shkurtër i krimeve për të cilat akuzohet i dyshuari, d.m.th, cilësimi juridik i fakteve të përshkruara. Këto kushte pasqyrojnë elementët thelbësorë të aktakuzës.

9. Në qoftë se konfirmohet, aktakuza i jep të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartësisht dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave kundër të akuzuarit për t'i mundësuar përgatitje të një mbrojtjeje adekuate.⁸ Për më tepër informacioni i mjaftueshëm lejon që i akuzuari të gjykohet

⁸ ECtHR, *Mattoccia v. Italy*, no. 23969/94, Judgment, 25 July 2000, para. 60; *See also*, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request Concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 October 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and All Related Disclosure Deadlines”, 15 May 2019, paras 41-42; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I, Pre-Trial Judge, Decision Relating to the Examination of the Indictment of 10 June 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra, 28 June 2011, para. 27; ICTR, *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-A, Appeals Chamber,

brenda një kohe të arsyeshme. Për këtë arsye, gjatë vlerësimit nëse janë përmbushur kushtet e nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake duhet t'u kushtojë vëmendjen e duhur të drejtave të të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21(4) të Ligjit.⁹

10. Prokurori përzgjedh dhe formulon akuzat.¹⁰ Ligji dhe Rregullorja nuk paracaktjnë një format të veçantë që ZPS-ja të ndjekë gjatë përgatitjes së aktakuzës dhe parashtrimit të akuzave brenda aktakuzës.¹¹ Gjithsesi, neni 21(4)(a) i Ligjit përcakton si garanci minimale që i akuzuari të informohet “në hollësi”, kurse neni 38(4) i Ligjit dhe rregulla 86(3) e Rregullores kërkojnë përshkrime “të shkurtra” të fakteve dhe krimeve. Kushti i informimit “në hollësi” dhe “shkurt[imisht]” do të thotë që informacioni parashtrohet me saktësi¹² dhe shkurtimisht, por duhet të jetë gjithëpërfshirës e jo i shpërhapur.¹³ Rrjedhimisht, një lexim i kombinuar i këtyre dispozitave kërkon konkretësi dhe qartësi në

Judgment, 7 July 2006, para. 22; *Prosecutor v. Nsengiyumva*, ICTR-96-12-I, Trial Chamber, Decision on the Defence Motion Raising Objections on Defects in the Form of the Indictment and to Personal Jurisdiction on the Amended Indictment, 12 May 2000, para. 1, p. 2; ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, Judgment, 23 October 2001, para. 88.

⁹ Neni 21(4)(a), (c) dhe (d) i Ligjit reflekton nenin 6(1), (3)(a) dhe (b) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe nenin 14(3)(a), (b) dhe (c) të Konventës Ndërkombëtare mbi Të Drejtat Civile dhe Politike. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 March 1999 [GC], paras 52, 54; *Sejdovic v. Italy*, no. 56581/00, 1 March 2006 [GC], Judgment, para. 90; Human Rights Committee, *Evelio Ramón Giménez v. Paraguay*, Communication no. 2372/2014, 25 July 2018, para. 7.10; *Arsen Ambaryan v. Kyrgyzstan*, Communication no. 2162/2012, 28 July 2017, para. 9.2.

¹⁰ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-422-Red, Pre-Trial Chamber II, Decision on the confirmation of charges against Dominic Ongwen, 23 March 2016, para. 106.

¹¹ *Sgih gjithashtu* ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 March 1999 [GC], para. 53.

¹² Sipas Fjalorit të Anglishtes të Oksfordit në Internet (Online Oxford English Dictionary), “në hollësi” do të thotë “zë për zë; pjesë për pjesë; imtësisht”, shih *OED Online* (Oxford University Press, December 2019), available at <https://www.oed.com/search?searchType=dictionary&q=in+detail&searchBtn=Search> (last accessed 25 February 2020).

¹³ Sipas Fjalorit të Anglishtes të Oksfordit në Internet (Online Oxford English Dictionary), “konciz” do të thotë “e shprehur në pak fjalë dhe gjithëpërfshirëse, jo e shpërhapur”, shih *OED Online* (Oxford University Press, December 2019), available at <https://www.oed.com/view/Entry/38276?rskey=nOeD&result=1#eid> (last accessed 25 February 2020).

përshkrimin e fakteve të çështjes dhe të krimeve, duke përfshirë edhe format e përgjegjesisë penale të paraqitura në aktakuzë. Vetëm një aktakuzë që përmbush këto kushte e vë të akuzuarin formalisht në dijeni.

11. Parimisht, aktakuza është një dokument i pavarur. Vlen të theksohet se i akuzuari nuk duhet të ketë nevojë të shohë dokumente të tjera që të kuptojë dhe të lidhë në tërësi pretendimet faktike mbi të cilat bazohen akuzat.

12. Rregulla 86(3)(a) dhe (b) e Rregullores përcakton se aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, gjegjësisht: (i) prova mbështetëse të fakteve materiale; dhe (ii) një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë, sidomos për sa u përket veprimeve të dyshuarit në lidhje me veprat penale të pretenduara. Të dy dispozitat lidhen me kushtin e paraqitjes së provave në mbështetje të fakteve materiale i cili është i ndryshëm nga kushti i dhënies së një përshkrimi të hollësishëm të fakteve dhe cilësimit të tyre juridik.¹⁴ Megjithëse materiali provues dhe përmbledhja e detajuar synojnë të mbështesin akuzat dhe tregojnë lidhjen e çdo prove me secilën akuzë, ato nuk duhen konsideruar si zëvendësuese ose shtesa të aktakuzës.

A. EMRI DHE TË DHËNAT E TË DYSHUARIT

13. Emri dhe të dhënat e të dyshuarit jepen me hollësi të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin jashtë çdo dyshimi të individit në fjalë. Kjo do të thotë se krahas emrit të plotë të dyshuarit, duke përfshirë edhe pseudonime apo shqiptim të ndryshëm të emrit, në aktakuzë jepen edhe të dhëna si data dhe vendi

¹⁴ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-1547-tENG, Trial Chamber II, Decision on Filing of a Summary of the Charges by the Prosecutor, 21 October 2008, para. 19; *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-2205, Appeals Chamber, Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prosecutor Against the Decision of Trial Chamber I of 14 July 2009 entitled "Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of the facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court", 8 December 2009, footnote 163; ICTY, *Prosecutor v. Stakić*, IT-97-24-A, Appeals Chamber, Judgment, 22 March 2006, para. 116.

i lindjes, numri i dokumentit të identifikimit, adresa aktuale dhe shtetësia, nëse janë të disponueshme. Gjithashtu së bashku me aktakuzën duhet të dorëzohet edhe një fotografi e kohëve të fundit.

B. PËRSHKRIMI I FAKTEVE

14. Faktet përshkruhen me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme për të informuar të akuzuarin mbi shkakun e akuzave, d.m.th., të gjitha faktet në lidhje me krimet, duke përfshirë edhe elementët kontekstualë, dhe veprimet e mosveprimet e të akuzuarit në lidhje me krime të veçanta mbi të cilat bazohet aktakuza.¹⁵ Rrjedhimisht duhet të paraqiten të gjitha faktet që janë të nevojshme për përmbushjen e elementëve përbërës të krimeve të pretenduara, duke përfshirë edhe elementët kontekstualë dhe format e propozuara të përgjegjësisë penale.¹⁶

15. Një aktakuzë nuk duhet të përmbajë pretendime të mjegullta me arsyetimin se ato do të sqarohen kur dhe nëse analizohen prova shtesë.¹⁷ Sidoqoftë, në varësi të

¹⁵ *Shih* ECtHR, *Mattoccia v. Italy*, no. 23969/94, Judgment, 25 July 2000, para. 59; *Penev v. Bulgaria*, no. 20494/04, 7 January 2010, Judgment, para. 33.

¹⁶ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Laurent Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-572 (OA5), Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of the Prosecutor Against the Decision of Pre-Trial Chamber I of 3 June 2013 Entitled "Decision adjourning the hearing on the confirmation of charges pursuant to article 61(7)(c)(i) of the Rome Statute", 16 December 2013, para. 47.

¹⁷ *Ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Delić*, IT-04-83-PT, Trial Chamber, Decision on Defence Motion Alleging Defects in the Form of the Indictment and Order on Prosecution Motion to Amend the Aktakuza, 13 December 2005, para. 16; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, Judgment, 28 February 2005, para. 30; *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-A, Appeals Chamber, Judgment, 3 May 2006, para. 25; ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, Trial Chamber, Decision on Severance of Andre Rëamakuba and for Leave to File Amended Indictment, 14 February 2005, para. 45; ICC, *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-2205, Appeals Chamber, Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prosecutor against the Decision of Trial Chamber I of 14 July 2009 Entitled "Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of the facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court", 8 December 2009, paras 90-91; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-A, Appeals Chamber, Judgment, 26 September 2013, para. 41.

natyrës së krimeve dhe rrethanave të rastit, konkretësia që kërkohet mund të jetë në shkallë të ndryshe.¹⁸

16. Rrjedhimisht, kur ngrihet pretendim se vetë i akuzuari ka marrë pjesë në veprimet bazë të krimit, është e nevojshme të jepet sa më qartë dhe me “saktësinë më të madhe”:¹⁹ identiteti i viktimës/viktimave; vendi dhe data e përafërt e veprimeve të pretenduara; mënyra dhe mjetet e kryerjes së këtyre veprimeve dhe elementi mendor në lidhje me këto veprime.²⁰

17. Nga ana tjetër, nëse pretendohet se i akuzuari nuk e ka kryer drejtpërdrejtë krimin, ose nëse duke u nisur prej natyrës së tyre këto krime synojnë një grup ose bashkësi njerëzish, të akuzuarit duhet t’i jepet sa më shumë që të jetë e mundshme informacion i hollësishëm lidhur me; vendet, kohën dhe numrin e përafërt të viktimave duke përfshirë edhe detaje të nevojshme për të dalluar elementët e krimeve; veprimet e pretenduara të të akuzuarit që çojnë në përgjegjësi penale, përfshirë një përvijim të planit të përbashkët, zbatimin e këtij plani si edhe kontributin e të akuzuarit në këtë plan; elementin mendor lidhur me këto veprime dhe identitetet e cilitdo bashkëkryes nëse dihet.²¹ Sido që të jetë, nuk lejohen

¹⁸ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 October 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngäïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and all Related Disclosure Deadlines”, 15 May 2019, paras 41-42.

¹⁹ *Ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25, Trial Chamber, Decision on Preliminary Motion on Form of Amended Indictment, 11 February 2000, para. 18; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, Judgment, 29 July 2004, para. 213. *See also*, SCSL, *Prosecutor v. Brima et al. (AFRC case)*, SCSL-2004-16-A, Appeals Chamber, Judgment, 22 February 2008, para. 38.

²⁰ *Ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, Judgment, 29 July 2004, para. 213; ICC, *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo against his Conviction, 1 December 2014, paras 122-123; *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges, 5 October 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngäïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and all Related Disclosure Deadlines”, 15 May 2019, paras 41-42.

²¹ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-tENG, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Defence Request Concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a

përshkrime të papërcaktuara të fakteve lidhur me veprimet e pretenduara (si për shembull “duke përfshirë, por jo vetëm”).²²

C. PARAQITJA E KRIMEVE

18. Paraqitja e krimeve duhet të burojë nga përshkrimi i fakteve dhe bëhet me konkretësi e qartësi të mjaftueshme për të informuar të akuzuarin mbi *natyrën* e akuzave, d.m.th, cilësimin ligjor të fakteve të pretenduara.²³ Megjithëse janë të ndërlidhur, paraqitja e krimeve dhe përshkrimi i fakteve nuk duhet të ngatërrohen me njëri-tjetrin. I dyti jep faktet e pretenduara, kurse i pari i cilëson ato në terma ligjore.

19. Paraqitja e krimeve përfshin jo vetëm (i) elementët përbërës të krimit në fjalë, dm.th., elementët kontekstualë (nëse është e zbatueshme) dhe aktet individuale bazë, por gjithashtu (ii) formën/format e përgjegjesisë penale që pretendohen në lidhje me çdo krim. Çdo element përbërës i krimit të pretenduar dhe çdo formë e përgjegjesisë penale të propozuar duhet të bazohet në pretendimet faktike që përfshihen në

Detailed Description of the Charges, 5 October 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, Decision on the “Prosecution’s Request to Postpone the Confirmation Hearing and All Related Disclosure Deadlines”, 15 May 2019, paras 41-42; *Prosecutor v. Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, Judgment on the Appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo Against his Conviction, 1 December 2014, para. 123.

²² *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-465-Red, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Confirmation of Charges, 16 December 2011, paras 82-83; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-373, Pre-Trial Chamber II, Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute, 23 January 2012, paras 99, 101 and 103; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-382-Red, Pre-Trial Chamber II, Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute, 23 January 2012, para. 106.

²³ ECtHR, *Pélissier and Sassi v. France*, no. 25444/94, Judgment, 25 March 1999 [GC], para. 51; *Mattoccia v. Italy*, no. 23969/94, Judgment, 25 July 2000, para. 59; *Penev v. Bulgaria*, no. 20494/04, Judgment, 7 January 2010, paras 33, 42; ICC, *Prosecutor v. Laurent Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-325, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Date of the Confirmation of Charges Hearing and Proceedings Leading Thereto, 14 December 2012, para. 25; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-1547-tENG, Trial Chamber II, Decision on Filing of a Summary of the Charges by the Prosecutor, 21 October 2008, para. 19.

përshkrimin e fakteve. Në veçanti, në një aktakuzë, format e përgjegjesisë penale nuk duhet të argumentohen pa pretendimet faktike përkatëse.²⁴

D. PËRFUNDIM

20. Duke u bazuar në sa më sipër, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se nevojitet informacion shtesë që Aktakuza të përmbushë kushtet e nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores. Në veçanti, Prokurori i Specializuar duhet të japë më shumë konkretësi dhe qartësi në paraqitjen e akuzave të identifikuar në pjesën e fundit të vendimit.

V. VENDIM

21. Në bazë të rregullës 86(4)(a) dhe (b) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron ZPS-në që të dorëzojë deri **të mërkurën, 18 mars 2020**:

- a) një fotografi të kohëve të fundit të z. Shala, nëse është e disponueshme;
- b) material provues shtesë mbi ekzistencën e një konflikti të armatosur jondërkombëtar midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") nga një njera anë dhe forcave të Republikës Federative të Jugosllavisë ("RFJ") dhe/ose Republikës së Serbisë nga ana tjetër, gjatë periudhës 17 maj – 5 qershor 1999;
- c) një aktakuzë të rishikuar, ku të përfshihen:
 - i. të dhënat personale dhe informacion identifikues tjetër i z. Shala, sikurse parashtrohet në paragrafin 13 më lart, nëse janë të disponueshme;
 - ii. një përshkrim me më shumë konkretësi i fakteve:

²⁴ *Ngjashëm, ICTY, Prosecutor v. Kvočka et al., IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, Judgment, 28 February 2005, para. 41.*

1. fakte që tregojnë ekzistencën dhe kohëzgjatjen e një konflikti të armatosur dhe cilësimin e tyre, ndër të tjera ekzistencën e një grupi të armatosur të organizuar dhe dhunën e zgjatur midis palëve në konflikt e dëshmuar prej intensitetit të luftimeve;
 2. pretendime faktike që i korrespondojnë secilit pretendim për krime të kryera në fabrikën e metalit në Kukës nga 17 maj deri më 5 qershor 1999 së bashku me pretendimet faktike që mbështesin lidhjen midis këtyre fakteve dhe konfliktit të armatosur;
 3. pretendimet faktike që lidhen me: (i) kryerjen fizike të krimeve që paraqiten në akuzat e Pikave 1-3, nga z. Shala; (ii) ekzistencën e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët për marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës; (iii) pjesëmarrjen e z. Shala në planin, projektin ose qëllimin e përbashkët për marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës dhe pasojat e saj; dhe (iv) ndihmën dhe inkurajimin prej z. Shala të krimeve të paraqitura në akuzat e Pikave 1-4;
- iii. një paraqitje me më shumë qartësi të krimeve:
1. cilësimi ligjor i pretendimeve faktike si krime lufte; dhe
 2. nëse është e nevojshme, mënyra se si veprimet dhe mosveprimet që mund t'i atribuohen z. Shala, përmbushin elementët përbërës të secilës formë të përgjegjësisë penale më vete; dhe
- d) parashtrime më vete në lidhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit, sikurse parashtrohet, ose në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976) që pasqyrohet në nenin 15(1)(a) të Ligjit, përfshirë elementët ligjorë.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i procedurës paraprake

E premte 28 shkurt 2020
Në Hagë, Holandë.